



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 756 Akti

Nr. 809 Vendimi  
Tiranë, më 22.10.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Roland Ilia</b>	Kryesues
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Relatore
<b>Xhensila Pine</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Suana Stafa, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 22.10.2024, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Orela Troplini**, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të

paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

**1.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**2.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Orela Troplini, aktualisht me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, është subjekt rivlerësimi, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**3.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.6.2021 zhvilloi procedurën e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Orela Troplini, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Xhensila Pine dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).

**4.** Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 2.7.2021 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues z. Roland Ilia, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

**5.** Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Orela Troplini, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

**6.** Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

**7.** Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**8.** Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e

veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**9.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); Këshilli i Lartë i Gjyqësor (KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

**10.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Orela Troplini. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**11.** Agjencia Kombëtare për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\*, datë 14.10.2022, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Orela Troplini.

**12.** Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport<sup>2</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**13.** Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

**14.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 3.10.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.1.2018.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2023.

prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**15.** Subjekti i rivlerësimit në datën 4.10.2024 u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit nuk e ushtroi të drejtën e saj për t'u njohur me aktet e dosjes, ndërsa më 17.10.2024 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

**16.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore<sup>3</sup>.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**17.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 17.10.2024.

**18.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 22.10.2024, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

**19.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Orela Troplini, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur e parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i kërkoi Komisionit konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**20.** Znj. Orela Troplini ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**21.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**21.1** Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>4</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë

<sup>3</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 17.10.2024.

<sup>4</sup> “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**22.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shpresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shpresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLGJ-ja; (ë) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**23.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

**23.1** Subjekti ka filluar detyrën në datën 6.9.2015 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

**23.2** ILDKPKI-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2021, informon se subjekti i rivlerësimit nuk mbart detyrimin për deklarimin e interesave privatë.

**23.3** Referuar të dhënave të dërguara nga Zyra e Gjendjes Civile Durrës (certifikatë martesë), rezulton se subjekti i rivlerësimit figuron me status “e martuar” me shtetasin E.T, në datën 12.1.2005, bazuar në aktin nr. \*\*\* të librit të martesës, martesë e cila ka zgjatur deri më 16.10.2019, për arsye të ndarjes nga jeta të bashkëshortit, referuar certifikatës së vdekjes së të ndjerit E.T, nr. \*\*, datë 27.9.2019, të Zyrës Vendore të Gjendjes Civile Durrës.

**23.4** Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

**24.** Apartament banimi<sup>5</sup> me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>, në Lagjen Nr. \*\*, z. k. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*-Nd+\*+\*\*, Durrës. Blerë në datën 28.2.2005 me kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, më pas me

---

*vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.*

<sup>5</sup> Subjekti ka depozituar: (i) kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\* kol., datë 28.2.2005; (ii) kontratë shitjeje apartamenti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.4.2012.

kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 14.4.2012, në shumën 40,000 USD. Subjekti sqaron se për efekt të udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008, noterët nuk lejoheshin të bënin shitje nën çmimin e referencës dhe ai i vendosur në kontratën e shitjes, 7,155,000 lekë, është çmimi i referencës, ndërsa çmimi real është ai në kontratën e sipërmarrjes. Zotëron 50% të kësaj pasurie.

**Burimi sipas deklaratës Vetting:** Biznesi i familjes së bashkëshortit, deri në vitin 2009 i njëjti trung familjar, si dhe të ardhurat nga paga.

**24.1 Konstatimi i ILDKPKI-së:** *Veprime të dyshimta lidhur me vlerat e likuiduara për blerjen e apartamentit me sipërfaqe ndërtimi 115 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe shfrytëzimi 96 m<sup>2</sup>, në Durrës, pasi rezulton të jenë nënshkruar dy kontratat me vlera të ndryshme (sipas kontratës së sipërmarrjes 40,000 USD dhe kontratës së shitjes 7,155,000 lekë).*

### **Hetimi<sup>6</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**25.** Në datën 28.2.2005 (përpara detyrës), me kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\* kol., i ndjeri, bashkëshorti i subjektit, ka porositur një apartament me sipërfaqe ndërtimi 115 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe shfrytëzimi 96 m<sup>2</sup>, për çmimin e 40,000 USD (4,133,200 lekë), shumë e cila është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale, në datën 28.2.2005.

**26.** Në datën 14.4.2012 është lidhur kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., për apartamentin me sipërfaqe totale 96 m<sup>2</sup>, me çmimin 7,155,000 lekë, shumë e likuiduar mes palëve jashtë zyrës noteriale.

**27.** Në lidhje me këtë çmim prej 7,155.000 lekësh, subjekti në deklaratën Vetting ka shpjeguar se është vendosur për efekt të udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008, pasi noterëve nuk i lejohej të bënin shitje nën çmimin e referencës. Pra, çmimi real i blerjes është 40,000 USD referuar deklaratës Vetting.

**28.** Subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1<sup>7</sup> ka vijuar të deklarojë: *“Kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\* kol., datë 28.2.2005, është një kontratë sipërmarrjeje ku palët janë dakordësuar për elementet thelbësore të kontratës, që përveç përshkrimit të objektit kanë përcaktuar edhe çmimin e kontratës prej 40,000 USD, që është paguar nga pala blerëse, po atë ditë që është lidhur kontrata. Kjo është edhe shuma që ne kemi paguar për blerjen e këtij apartamenti... Për efekt të regjistrimit të njërive të veçanta që ka ky objekt, si apartamente, garazhe, dyqane, në emër të palëve blerëse janë ribërë këto kontrata tashmë jo si kontrata sipërmarrjeje, por si kontrata shitjeje përfundimtare, me qëllim për të bërë kalimin e pronësisë në ASHK nga firma e ndërtimit tek individët që kanë blerë këto apartamente. Përcaktimi i çmimit të apartamentit në këtë kontratë 7,155,000 lekë (shtatë milionë e njëqind e pesëdhjetë*

---

<sup>6</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2021, drejtuar FSHU-së; kthim përgjigjeje e FSHU-së nr. \*\*\* prot., datë 16.09.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., date 8.9.2021, drejtuar ASHK-së Durrës; kthim përgjigjeje e ASHK-së Durrës nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; kthim përgjigjeje nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2021, drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit; kthim përgjigjeje e QKB-së nr. \*\*\* prot., datë 22.9.2021.

<sup>7</sup> Subjekti ka bashkëngjitur: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 13.9.2019, në emër të shtetasit K.S. N(sipas subjektit emri i mëparshëm H.S.D), me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>, në Lagjen Nr. \*\*, Durrës, bashkëngjitur harta reguese e pasurisë; (ii) vërtetim datë 18.6.2012 lëshuar nga shoqëria ndërtimore “D-A” sh.p.k., në lidhje me vlerën e paguar prej 40,000 USD për apartamentin nga shtetasi H.D; (iii) kontratë shitblerjeje apartamenti me palë shitëse shoqëria ndërtimore “D-A” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasja G.D, apartament me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup>, në Lagjen Nr. \*\*, Durrës, i cili është shitur me çmimin 23,000 USD.

e pesë mijë lekë) është dakordësuar nga palët për shkak të çmimit të referencës së apartamenteve të përcaktuar me VKM-në që ka qenë në fuqi në kohën e realizimit të kontratës”.

**28.1** Komisioni, pavarësisht shpjegimeve të subjektit, do të përfshijë në analizë financiare vlerën e përcaktuar në kontratën e shitblerjes 7,155,000 lekë.

**29.** Në datën 23.4.2012, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i ndjerë E.T rezultojnë të jenë pajisur me certifikatën e pronësisë për pasurinë e llojit apartament nr. \*\*\*-Nd+\*\*, në zonën kadastrale \*\*\*, me sipërfaqe totale 96 m<sup>2</sup>, ndodhur në Lagjen Nr. \*\*, rruga “V. K”, Durrës.

### **Në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti**

**30.** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se burimi i të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie në vlerën 40,000 USD është biznesi i familjes së bashkëshortit, deri në vitin 2009 i njëjti trung familjar, si dhe të ardhurat nga paga.

i) Për të vërtetuar të ardhurat nga biznesi i familjes së bashkëshortit, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*:

- a. ekstrakt historik të regjistrimit tregtar për shoqërinë “A.M” sh.p.k., sipas të cilit ky subjekt është themeluar në datën 8.5.1995, me objekt aktiviteti “...kryerja e operacioneve tregtare të eksportit të produkteve të peshkimit, të importit të produkteve itike të ngrira dhe ushqimeve në përgjithësi, për të plotësuar kërkesat në rritje të merkatës shqiptare...”;
- b. ekstrakt historik të regjistrimit tregtar për personin fizik “E.T”, sipas të cilit ky subjekt është regjistruar në QKB në datën 31.7.2009, nën emrin tregtar “B”;
- c. shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2016, nga DRT Durrës, sipas së cilës shtetasi B.T është administrator i shoqërisë “A.M” sh.p.k., me NIPT J\*\*\*B , me seli në Durrës, i regjistruar në datën 8.4.1999;
- d. shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2016, nga DRT Durrës, e cila konfirmon se shtetasi B.T në cilësinë e administratorit ka derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën dhjetor 2011 – shtator 2016, ndërsa i ndjeri E.T, i punësuar pranë shoqërisë “A.M” sh.p.k., ka derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën korrik 2015 – shtator 2016;
- e. deklaratë “Listëpagesë e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi” për periudhën gusht – dhjetor 2016, për punonjësit e shoqërisë “A.M” sh.p.k.;
- f. vërtetim për bazën e vlerësueshme, punëdhënësi “A.M” sh.p.k. dhe punëmarrësi E.T, sipas të cilit të ardhurat neto të realizuara për periudhën janar 1996 – maj 2010 janë në vlerën 1,419,001.00 lekë.

ii) Për të provuar të ardhurat nga aktiviteti tregtar si person fizik të bashkëshortit, të ndjerit E.T, subjekti ka depozituar në pyetësorin standard sa më poshtë vijon:

- a. shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2010, lëshuar nga departamenti i taksave, Bashkia Durrës, ku rezulton se xhiroja e planifikuar e vitit 2010 të subjektit “E.T”, me NIPT K\*\*\*U, është 3-4 milionë lekë;
- b. faturë arkëtimi datë 29.9.2010, sipas së cilës subjekti me NIPT K\*\*\*U ka shlyer detyrimin mbi taksat e ushtrimit të aktivitetit si biznes i vogël, si dhe taksat e

- detyrueshme të bashkisë, përkatësisht në vitin 2009 në vlerën totale 79,375 lekë dhe në vitin 2010 në vlerën 84,375 lekë;
- c. akt kontrolli datë 28.9.2010, lëshuar nga departamenti i taksave, Bashkia Durrës, sipas të cilit subjekti “E.T”, me NIPT K\*\*\*U, kualifikohet në xhiron 3-4 milionë lekë;
  - d. deklaratë parashikuese e qarkullimit vjetor nënshkruar nga shtetasi E.T, por pa të dhëna deklaruese për vitet 2009 dhe 2010;
  - e. faturë arkëtimi datë 18.2.2011, sipas së cilës subjekti me NIPT K\*\*\*U ka shlyer detyrimin mbi taksat e ushtrimit të aktivitetit si biznes i vogël, si dhe taksat e detyrueshme të bashkisë, përkatësisht në vitin 2011 në vlerën totale 21,750 lekë dhe gjobë për mospagim në afat në vitin 2009, në vlerën 15,875 lekë;
  - f. faturë arkëtimi datë 10.4.2012, sipas së cilës subjekti me NIPT K\*\*\*U ka shlyer detyrimin mbi taksat e ushtrimit të aktivitetit si biznes i vogël, si dhe taksat e detyrueshme të bashkisë, përkatësisht në vitin 2011 në vlerën totale 21,750 lekë dhe në vitin 2012 në vlerën 15,000 lekë;
  - g. deklaratë parashikuese e qarkullimit vjetor nënshkruar nga shtetasi E.T, për vitin 2010 qarkullimi faktik është 1,000,000 lekë dhe për vitin 2012 qarkullimi vjetor i parashikuar është 1,000,000 lekë;
  - h. faturë arkëtimi datë 17.4.2013, sipas së cilës subjekti me NIPT K\*\*\*U ka shlyer detyrimin mbi taksat e ushtrimit të aktivitetit si biznes i vogël, si dhe taksat e detyrueshme të bashkisë, përkatësisht në vitin 2013 në vlerën totale 25,000 lekë;
  - i. deklaratë parashikuese e qarkullimit vjetor, nënshkruar nga shtetasi E.T për vitin 2013, me qarkullim faktik 1,000,000 lekë;
  - j. faturë arkëtimi datë 31.3.2014, sipas së cilës subjekti me NIPT K\*\*\*U ka shlyer detyrimin mbi taksat e ushtrimit të aktivitetit si biznes i vogël, si dhe taksat e detyrueshme të bashkisë, përkatësisht në vitin 2014 në vlerën totale 10,000 lekë;
  - k. pasqyrë ndjekjeje e subjektit sipas viteve për shlyerjen e detyrimeve, sipas së cilës detyrimet e kryera për vitin 2009 janë në vlerën 63,500 lekë, për vitin 2010 në vlerën 99,375 lekë, për vitin 2011 në vlerën 21,750 lekë, për vitin 2012 në vlerën 60,000 lekë dhe për vitin 2013 në vlerën 40,000 lekë.

Komisioni i është referuar tatimit të paguar nga i ndjeri, bashkëshorti i subjektit, për periudhën 2009 – 2011, për të nxjerrë xhiron dhe më pas fitimin për këto vite, ndërsa për vitet 2012 – 2014 i është referuar të dhënave nga sistemi C@TS.

iii) Komisioni ka kryer përlllogaritjen e fitimit të krijuar nga aktiviteti tregtar i të ndjerit, bashkëshortit të subjektit E.T, me NIPT K\*\*\*U, për periudhën 2009 – 2014, duke aplikuar masën e marzhit të fitimit 75% për vitet në të cilën mungojnë të dhënat mbi fitimin. Nga kjo llogaritje rezulton se për vitet 2009 – 2014 i ndjeri ka realizuar një fitim në shumën totale prej 5,803,675 lekësh.

**31.** Nga hetimi i Komisionit në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit dhe familjarëve të tij, rezulton se:

i. DPT-ja informon se:

- E.T, i datëlindjes 21.4.1977, me ID H\*\*\*D, ka pasur aktivitet ekonomik të regjistruar në emër të tij me NIPT K\*\*\*U, nën emrin tregtar “P”, me objekt aktiviteti “Zënie dhe tregtim peshku”, regjistruar në datën 31.7.2009.



Nga ekstrakti historik i punonjësit rezulton se:

- Për periudhën dhjetor 2011 – maj 2015 ka derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si administrator i shoqërisë “P” sh.p.k., me status aktual “aktiv”.
- Për periudhën korrik 2015 – qershor 2019 ka derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si i punësuar pranë shoqërisë “A.M” sh.p.k.
- Shtetasi E.T është objekt i DIVA për vitin 2017 dhe deklaruar për këtë vit 2017 të ardhura bruto nga paga 600,000 lekë, për të cilat shuma e tatimit të paguar është 31,200 lekë dhe të ardhura bruto nga qiraja 2,400,000 lekë, për të cilat shuma e tatimit të paguar është 360,000 lekë.
- Nga të dhënat e sistemit C@TS rezulton se shtetasi E.T ka deklaruar të ardhura, shpenzime, fitim-humbje të subjektit “P” sh.p.k., ndër vite, paraqitur në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 1**

Periudha	Të ardhura	Shpenzime	Fitim/humbje	Tatimi fix
2012	1,325,000		1,325,000	
2013	1,410,500		-	
2014	1,545,800	0	1,545,800	25,000
2015	-	-	0	
2016	-	-	-	-
2017	-	-	-	-
2018	-	-	-	-
2019	1,393,750	1,465,351	-71,601	25,000

- B.T, i datëlindjes 20.1.1953, me ID F\*\*\*B, rezulton se:
  - Ka aktivitet ekonomik të regjistruar në emër të tij, është administrator i subjektit “A.M” sh.p.k., me NIPT J\*\*\*E<sup>8</sup>, themeluar më 9.5.1996, me status “aktiv”, DRT Durrës. Për këtë subjekt nuk ka asnjë deklaratë.
  - Ka aktivitet ekonomik të regjistruar në emër të tij, është administrator dhe aksioner me 79.75% i subjektit “A.M” sh.p.k., me NIPT J\*\*\*B, themeluar më 8.4.1999, me status “aktiv”, DRT Durrës.

Nga ekstrakti historik i punonjësit rezulton se:

- Për periudhën dhjetor 2011 e në vazhdim ka derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si administrator i shoqërisë “A.M” sh.p.k., me status aktual “aktiv”. Për vitin 2015 ka deklaruar fitim 1,420,657 lekë, për vitin 2016 ka deklaruar fitim 1,962,251 lekë, për vitin 2017 ka deklaruar fitim 4,448,058 lekë, për vitin 2018 ka deklaruar fitim 554,295 lekë, për vitin 2019 ka deklaruar fitim 1,332,234 lekë, ndërsa për vitin 2020 ka deklaruar fitim 1,762,805 lekë.
- L.T, e datëlindjes 5.11.1957, me ID F\*\*\*D, nga ekstrakti historik i punonjësit rezulton se:

<sup>8</sup> Në lidhje me këtë shoqëri, nga verifikimi i të dhënave në regjistrin tregtar rezulton se është e njëjtë me shoqërinë e mëposhtme.

- Për muajt maj 2014 – korrik 2018 ka derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si e punësuar pranë shoqërisë “A.M” sh.p.k.
- ii. Nga ana e DRT-së Durrës (shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.7.2017) rezulton se shoqëria “A.M” sh.p.k. ka fitim neto për periudhën 2001 – 2009 në vlerën 6,135,025 lekë, për periudhën 2010 – 2011 rezulton me humbje në shumën -10,309,975 lekë dhe për periudhën 2012 – 2016 me fitim neto në shumën 4,617,756 lekë. Kjo shoqëri ka bërë shpërndarje të fitimit në vitin 2004 në vlerën 500,000 lekë, duke kryer edhe pagesën për dividend në shumën 50,000 lekë.

Bazuar në të dhënat e administruar nga ekstrakti historik në lidhje me këtë shoqëri, rezulton se fillimisht shtetasi B.T ka pasur 4.61% të kuotave të kapitalit. Në vitin 1996 ai ka pasur 14% të kuotave të kapitalit, pasi disa nga ortakët janë larguar nga shoqëria, duke zvogëluar kapitalin e saj. Në vitin 1997, babai i bashkëshortit të ndjerë të subjektit ka blerë 14% të kuotave të kapitalit, në shumën 3,463 USD. Në vitin 2015 është shtuar kapitali i shoqërisë me kontributin në natyrë (motopeshkatore) të z. T, duke u bërë zotërues i 74.87% të kuotave të kapitalit.

Në lidhje me të ardhurat nga ky aktivitet do të përfshihet në analizën financiare vetëm shuma 500,000 lekë, e cila do të merret në vlerën takuese që ka pasur z. T në vitin 2004.

iii. QKB-ja informon se:

- E.B.T, i datëlindjes 21.4.1977, figuron i regjistruar si person fizik me NIPT K\*\*\*U, aktualisht me status “i çregjistruar”. Nga ekstrakti historik i regjistrimit për këtë person fizik rezulton se fusha e veprimtarisë është “Zënie dhe tregtim peshku”, vendi i ushtrimit të veprimtarisë është anija “B”, me nr. \*\*\*, emri tregtar “P”, data e regjistrimit 31.7.2009.
- B.T figuron administrator në shoqërinë “A.M” sh.p.k., me NIPT J\*\*\*E. Ky subjekt është transferuar në QKB nga organet tatimore dhe nuk ka kryer plotësimin e të dhënave në këtë institucion. Nga ekstrakti historik i regjistrimit për këtë subjekt rezulton emri tregtar “A.M”, data e regjistrimit 9.5.1996.
- B.I.T, i datëlindjes 20.1.1953, figuron të jetë administrator dhe ortak, zotërues i 79.75% të kuotave në shoqërinë “A.M” sh.p.k., me NIPT J\*\*\*B.

Nga ekstrakti historik i regjistrimit për këtë subjekt rezulton se fusha e veprimtarisë është “Administrimi në dhënie e autorizimeve përkatëse nga autoritete kompetente të pasurisë në fushën bregdetare shqiptare... realizim dhe administrim të impianteve për mbledhje, konservim, mbingrirje dhe transformim të produkteve nga peshkimi etj...”; vendi i ushtrimit të veprimtarisë është Porti Detar Durrës; emri tregtar “A.M”; data e regjistrimit 8.4.1999; ortakët B.T, zotërues i 79.75% të kuotave në shoqërinë “A.M” sh.p.k. dhe “\*\*\*”, zotërues i 20.25% të kuotave në këtë shoqëri.

**32.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 1 në lidhje me të ardhurat e deklaruara si burim për blerjen e pasurive, subjekti ka deklaruar se: *“Përveç shoqërisë “A.M” sh.p.k., e cila rezulton se nuk ka shpërndarë dividend, vjehri im, shtetasi B.T, ka zhvilluar aktivitet tregtar jo vetëm si person juridik, por edhe si person fizik, me objekt “Zënie dhe tregti peshku”, ku ka pasur në pronësi disa anije peshkimi në periudha të ndryshme, biznes në të cilin ka qenë e punësuar e gjithë familja. Nga aktiviteti tregtar si person fizik ai ka gjeneruar të ardhura të konsiderueshme si pasojë e zënies dhe tregtimit të peshkut, ku dua të theksoj se ka qenë një ndër bizneset e para*

*në qytetin e Durrësit me këtë veprimtari, aktivitet të cilin e ka ushtruar edhe bashkëshorti im deri në momentin që ndërroi jetë.*

*...Në lidhje me të ardhurat që ka sjellë aktiviteti si person fizik, sqaroj edhe një herë që ato kanë qenë të konsiderueshme, por për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe mënyrës se si operohej në ato vite, pasi flitet për vitin 1994 e në vazhdim, ku transaksionet kryheshin me para në dorë dhe në kushte mirëbesimi e kam të pamundur t'i provoj në mënyrë shkresore...”.*

**32.1** Për të provuar këto të ardhura, subjekti i ka bashkëlidhur pyetësorit nr. 1 sa më poshtë vijon:

- i. certifikatë regjistrimi në organin tatimor me nr. serial \*\*\*, kodi fiskal \*\*\*, për anijen “N. C”, regjistruar me vendim gjykate nr. \*\*\*, datë 13.2.1996;
- ii. certifikatë regjistrimi në organin tatimor me nr. serial \*\*\*, kodi fiskal \*\*\*, për anijen “I. C”, ku “si pjesëtar i familjes që angazhohet” në këtë aktivitet rezulton edhe emri E.T, që është bashkëshorti i saj i ndjerë;
- iii. vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 10.9.2024, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës në emër të shtetasit B.I.T;
- iv. vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 13.9.2024, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës në lidhje me vitet e punës që bashkëshorti E.T ka derdhur kontribute, gjithsej 20 vite e 1 muaj;
- v. vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 13.9.2024, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës në lidhje me vitet e punës që vjehri B.T ka derdhur kontribute, gjithsej 39 vite e 2 muaj.

**33.** Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>9</sup> lidhur me mundësinë e pagesës së apartamentit sipas kontratës së shitblerjes në vlerën 7,155,000 lekë, përkatësisht pagesën prej 40,000 USD në datën 28.2.2005, me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes, si dhe vlerën e mbetur në datën e nënshkrimit të kontratës së shitjes, 14.4.2012.

**33.1** Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit nga punësimi, në total 484,175.17 lekë;
- shpenzimet jetike të llogaritura për vitin 2005 për 5 persona, ndërsa për vitin 2012 për 4 persona, në varësi të përbërjes familjare;
- të ardhurat nga puna e subjektit dhe personave të lidhur me të;
- të ardhurat nga aktiviteti tregtar i shtetasit B.T vetëm për vitin 2004;
- të ardhurat nga aktiviteti tregtar i shtetasit E.T;
- pakësimi i likuiditeteve në bankë në shumën 924,597.86 lekë, për këstin e parë;
- shpenzimet për shkollimin e vajzës G.T;
- detyrimet financiare ndaj institucioneve bankare;
- në analizë nuk janë përfshirë të ardhurat e pretenduar nga aktiviteti i peshkimit, pasi nga subjekti nuk është përcaktuar vlera totale e tyre, si dhe nuk është provuar pagimi i detyrimeve tatimore.

---

<sup>9</sup> Shihni tabelat nr. 1 dhe nr. 2 të rezultateve të hetimit.

**33.2** Nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2005, në vlerën 486,668.86 lekë, dhe në vitin 2012, në vlerën 2,820,808.49 lekë, në total 3,307,477.35 lekë.

**33.3** Në lidhje me këto rezultate hetimi, duke marrë në konsideratë se kjo pasuri është krijuar përpara fillimit të detyrës së saj, subjektit iu kërkuan shpjegime.

**34.** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se<sup>10</sup>: *“Çmimi real që është paguar për këtë apartament është 40,000 USD sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\* kol., datë 28.2.2005. Në kontratën e shitjes është shënuar çmimi 7,155,000 lekë, fakt për të cilin kam deklaruar se është shënuar për shkak të udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008, pasi noterëve nuk i lejohej të hartonin kontrata shitjeje, ku palët mund të deklaronin një çmim më të ulët se ai i përcaktuar në VKM... Nga informacionet e marra nga Drejtoria Rajonale Tatimore rezulton se vjehri im B.T është i regjistruar si person juridik që në vitin 1995 pranë këtij institucioni dhe si person fizik që në vitin 1996. Është e vërtetë që fitimi i deklaruar mund të duket i pamjaftueshëm, por ju sjell në vëmendje që të merrni parasysh edhe kushtet në të cilat zhvillohej tregtia në ato vite, e cila ishte totalisht në kushte informale, për këtë shkak e kam të pamundur t’i provoj në mënyrë shkresore sa kanë qenë realisht fitimet në atë periudhë. Por di t’ju them se në atë periudhë kanë qenë dy anije, të cilat administroheshin nga familja jonë dhe se bashkëshorti im dhe vjehri iknin me ditë të tëra në det”.*

**34.1** Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës shkresën kthim përgjigjeje të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2024.

**35.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, vlerëson se nga ana e saj nuk rezulton të jetë provuar me dokumentacion tatimor të ardhurat nga aktiviteti i peshkimit. Për rrjedhojë, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e apartamentit në vitin 2005.

**35.1** Komisioni, duke marrë në konsideratë se:

- a. kjo pasuri është krijuar në vitin 2005, shumë kohë përpara se subjekti të kishte filluar detyrën;
- b. babai i bashkëshortit të saj të ndjerë rezulton me një aktivitet të regjistruar që në vitin 1996, si dhe me një fitim të konsiderueshëm, për të të cilin nuk është shpërndarë dividend. Gjithashtu, subjekti ka provuar që përveç aktivitetit tregtar ai ka pasur të regjistruara edhe dy anije peshkimi;
- c. bashkëshorti i saj i ndjerë rezulton i punësuar në këtë aktivitet që në vitin 1996;
- d. subjekti nuk është dhe nuk ka qenë asnjëherë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së;
- e. nuk lindin dyshime që subjekti është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri;
- f. subjekti pas marrjes së detyrës dhe në vijim rezulton me burime të ligjshme për krijimin e pasurive të saj;
- g. subjekti në asnjë rast nuk ka pasur detyra zyrtare për t’u ngritur dyshime për fshehje apo mosdeklarim të ardhurash të krijuara nga burime jo të ligjshme,

– vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme, që kënaqin kërkesat e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës

---

<sup>10</sup> Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

disiplinore të shkarkimit ndaj subjektit të rivlerësimit. I njëjti qëndrim, për të mos rënë në përsëritje, vlen edhe për pasuritë e krijuar nga i ndjeri, bashkëshorti i subjektit, përpara fillimit të detyrës së saj, të analizuar në vijim të këtij vendimi.

### **36. Llogari depozitë pranë Tirana Bank**

### **37. Llogari kursimi pranë Raiffeisen Bank**

### **38. Llogari rrjedhëse (page) pranë Raiffeisen Bank (16.5.2005 – 23.1.2009)**

### **39. Llogari rrjedhëse (page) pranë Alpha Bank (2.3.2009 – 11.6.2020)**

### **40. Llogari rrjedhëse (page) pranë Credins Bank (11.6.2020 e në vazhdim)**

Në lidhje me këto llogari, nuk janë konstatuar depozitime/transferime apo lëvizje të dyshimta. Këto llogari kanë shërbyer si llogari page, si dhe llogari për kalimin e kredisë apo të bonusit për familjet e prekura nga tërmeti.

Në **përfundim** konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin.

## **DEKLARIMI I PASURIVE TË BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT – E.T**

**41. Anije peshkimi “B”<sup>11</sup>**, prodhim i vitit 1995, blerë me kontratën për shitblerje anije datë 7.4.2009, blerje me bankë. Vlera: 30,000 euro.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting***: Biznesi i familjes deri në vitin 2009, si dhe të ardhurat e familjes.

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**42.** Në datën 7.4.2009 (përpara detyrës), bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, i ndjeri E.T, ka lidhur kontratë individuale të shitblerjes me shoqërinë “P” sh.p.k. M të Federatës R, me qëllim blerjen e anijes së peshkimit “B”, në çmimin 30,000 euro.

**43.** PAGESA provohet me transfertë bankare datë 14.4.2009, nr. \*\*\*, me urdhërues të tarifës shtetasin E.T dhe përfitues shtetasin e huaj B.M (përfaqësues me prokurë i shoqërisë “P”), në shumën 30,000 euro, nën komentin “*Payment based on contract nr. \*\*\*, datë 7.4.2009*”, veprim për të cilin është mbajtur komisioni bankar në shumën 75 euro.

**44.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.6.2017, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (gjendur në dosjen e ILDKPKI-së), është vënë në dispozicion dëshmia e pronësisë e anijes së peshkimit “B” nr. \*\*\*, datë 15.7.2009, në emër të shtetasit E.T.

**45.** Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>12</sup> lidhur me mundësinë e blerjes së pasurisë anije peshkimi sipas kontratës së shitblerjes, në vlerën 30,000 USD. Kjo pasuri është krijuar përpara detyrës së subjektit.

#### **45.1** Në analizën financiare janë përfshirë:

- i. të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit nga punësimi;

---

<sup>11</sup> Subjekti ka depozituar: (i) dëshminë e pronësisë së anijes së peshkimit “B”, e regjistruar në Portin e Durrësit me nr. \*\*\*, datë 15.7.2009, në pronësi të shtetasit E.T; (ii) kontratë shitblerjeje anije datë 7.4.2009, me vlerë 30,000 euro; (iii) mandatpagesa datë 14.4.2009, në Union Bank, për pagesën 30,000 euro, së bashku me transferimin e shumës nga blerësi E.T tek shitësi.

<sup>12</sup> Shihni tabelën nr. 2 të rezultateve të hetimit.

- ii. të ardhurat e prindërve të bashkëshortit të subjektit, B dhe L.T;
- iii. detyrimet financiare ndaj institucioneve bankare për kreditë e marra në to;
- iv. shpenzimet jetike për 5 persona;
- v. shpenzime mobilimi deklaruar nga subjekti në pyetësorin standard;
- vi. shpenzimet TIMS;
- vii. në këtë analizë nuk janë përfshirë të ardhurat nga aktiviteti tregtar i shtetasit B.T, pasi nuk provohet shpërndarja e dividendit dhe pagimi i detyrimeve tatimore.

**46.** Nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2009, në vlerën -1,524,684.20 lekë.

**46.1** Në lidhje me këtë rezultat hetimi, duke marrë në konsideratë se kjo pasuri është krijuar përpara fillimit të detyrës së saj, subjektit iu kërkuan shpjegime.

**47.** Pas dërgimit të rezultate të hetimit, subjekti sqaroi<sup>13</sup>: *“...familja e bashkëshortit tim ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga aktiviteti tregtar që ushtronte, por për shkak të informalitetit e kam të pamundur të provoj në mënyrë shkresore fitimin. Ndër vite ata kanë shitur dhe kanë blerë disa anije peshkimi. Aktualisht vjehri im ka dy anije në pronësi, konkretisht anijen e peshkimit “Kap. E.T” dhe “A-T”, është dhe ortak me 100% të kuotave në shoqërinë “A.M” sh.p.k..”*

**48.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, vlerëson se nga ana e saj nuk rezulton të jenë provuar me dokumentacion tatimor të ardhurat nga aktiviteti i peshkimit. Për rrjedhojë, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e anijes në vitin 2009. Komisioni, duke marrë në konsideratë konkluzionet në pikën 35 të këtij vendimi, vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme që kënaqin kërkesat e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit ndaj subjektit të rivlerësimit.

**49. Motor lundrues “G<sup>14</sup>”,** prodhim i vitit 1995, blerë me kontratën individuale datë 9.9.2014 në vlerën 127,102 lekë + zhdoganim.

**Burimi sipas deklaratës Vetting:** Të ardhurat nga paga.

#### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**50.** Në datën 19.9.2014 (përpara detyrës), i ndjeri E.T rezulton të jetë pajisur me dëshmi aftësie për mjetet e vogla lundruese, me nr. \*\*\* regjistri, të mjetit të vogël lundrues të quajtur “G”<sup>15</sup>, pasuri të cilën e ka përfutuar nëpërmjet autovërtetimit të datës 9.9.2014, me nr. \*\*\* rep., të lëshuar prej shtetasit të huaj (italian) P.B, për çmimin 500 euro.

<sup>13</sup> Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

<sup>14</sup> Subjekti ka depozituar: (i) dëshmi të aftësisë së lundrimit për mjete të vogla, nr. regjistri \*\*\* “G”, datë 19.9.2014, në emër shtetasit E.T; (ii) vërtetim shitjeje automjeti, jo në ushtrim të biznesit, nr. \*\*\* rep., datë 9.9.2014, për blerjen e një barke, data e matrikullimit 3.1.1991, me çmim 500 euro; (iii) faturë doganore datë 19.8.2014 për zhdoganimin e mjetit lundrues të vitit 1991.

<sup>15</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.6.2017, e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së.

**51.** Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>16</sup> lidhur me mundësinë e blerjes së pasurisë mjet lundrues sipas kontratës së shitblerjes, në vlerën 500 euro. Kjo pasuri është krijuar përpara detyrës së subjektit.

**51.1** Në analizën financiare janë përfshirë:

- i. të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit nga punësimi;
- ii. të ardhurat nga aktiviteti privat si person fizik i shtetasit E.T, me NIPT K\*\*\*U;
- iii. detyrimet financiare ndaj institucioneve bankare për kreditë e marra në to;
- iv. shpenzimet jetike për 4 persona;
- v. shpenzimet e zhdoganimit për mjetin e lundrimit;
- vi. shpenzimet TIMS.

**51.2** Nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin pasurisë motor lundrues, në vlerën 500 euro.

**52.** Në lidhje me këtë mjet, ai rezulton të jetë shitur nga subjekti me kontratën nr. \*\*\*, datë 3.9.2020, për shumën 3,500 euro.

Në **përfundim** konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin.

**53. Automjet tip “Mercedes-Benz \*\*\*”<sup>17</sup>**, prodhim i vitit 2000, me targë AA \*\*\* AR, blerë në datën 17.10.2010 + zhdoganim. Vlera: 435,668 lekë.

**Burimi sipas deklaratës Vetting:** Të ardhurat nga pagat.

**Hetimit<sup>18</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**54.** Në datën 17.10.2010 (përpara detyrës), i ndjeri E.T, bashkëshorti i subjektit, ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz” MB 170 CDI, për shumën 1,750 euro. Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2011, lëshuar nga drejtoria e doganave, rezulton se ka të bashkëngjitur procesverbalin nr. \*\*\*, nga ku konfirmohet se automjeti i përdorur tip “Mercedes-Benz”, model \*\*\*, me targë BW \*\* BG, vit prodhimi 2000, ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë në datën 5.2.2010.

**54.1** Në datën 19.10.2011, për efekt të ligjit nr. 10418, datë 21.4.2011, bazuar në nenin 26, pika 4, shtetasi E.T është pajisur me deklaratën doganore të automjetit të sipërpërmendur, në vlerën 1,750 euro + 166,281 lekë detyrime doganore. Këtë automjet i ndjeri, bashkëshort i subjektit, e ka shitur në vlerën 150,000 lekë, në datën 12.9.2017, me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.

**55.** Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>19</sup> lidhur me mundësinë e blerjes së pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz 168” sipas dokumentacionit provues, në vlerën 1,750 euro. Kjo pasuri është krijuar përpara detyrës së subjektit.

---

<sup>16</sup> Shihni tabelën nr. 3 të rezultateve të hetimit.

<sup>17</sup> Subjekti ka depozituar: leje qarkullimi datë 9.9.2013 të mjetit tip “Mercedes-Benz 210”, me targë AA \*\*\* HI, në pronësi të shtetasit E.T; kontratë shitjeje datë 27.8.2013, sipas vërtetimit noterial datë 9.9.2013.

<sup>18</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2011, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; kthim përgjigjeje e DPSHTRR-së nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2021.

<sup>19</sup> Shihni tabelën nr. 4 të rezultateve të hetimit.

### 55.1 Në analizën financiare janë përfshirë:

- i. të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit nga punësimi;
- ii. të ardhurat nga aktiviteti privat si person fizik i shtetasit E.T, me NIPT K\*\*\*U;
- iii. detyrimet financiare ndaj institucioneve bankare për kreditë e marra në to;
- iv. shpenzimet jetike për 4 persona;
- v. shpenzimet e shkollimit për vajzën G. T;
- vi. shpenzimet TIMS.

56. Nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz 168”, në vlerën 1,750 euro.

**Në përfundim** konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin.

57. **Automjet tip “J”**<sup>20</sup>, prodhim i vitit 2003, me targë AA \*\*\* CT, blerë në datën 20.12.2011 + zhdoganim. Vlera: 2,551,883 lekë.

**Burimi sipas deklaratës Vetting:** Të ardhurat nga pagat dhe biznesi.

### Hetimi<sup>21</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

58. I ndjeri, bashkëshorti i subjektit, ka blerë me deklaratë shitjeje automjetin tip “J”, për shumën 2,000 euro. Në datën 20.12.2011 (përpara detyrës) është zhdoganuar automjeti dhe bazuar në deklaratën doganore rezulton se ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë më 27.6.2009, me çmim 15,520 euro. Bazuar në procesverbalin nr. \*\*\*, datë 20.12.2011, konstatohet se është paguar pagesa e detyrimeve doganore në shumën 361,458 lekë për efekt të plotësimit të kushtit të faljes, pasi, siç rezulton, automjeti ka hyrë në Shqipëri në vitin 2009. Në datën 20.2.2012, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. E.T, është lëshuar leja e qarkullimit rrugor për automjetin tip “J”, modeli XY, vit prodhimi 2003, me targë AA \*\*\* CT.

59. Komisioni, duke u referuar në deklaramin e subjektit në deklaramin *Vetting*, por edhe në deklaramin e të ndjerit/bashkëshortit të saj në deklaramin doganore, do të konsiderojë çmimin e automjetit në shumën 15,520 euro, pavarësisht se në kontratën e shitjes është vënë çmimi prej 2,000 euro. Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>22</sup> për mundësinë e blerjes së këtij automjeti për periudhën 7.9.2009 – 2011, pasi analiza për periudhën para datës 7.9.2009 është pasqyruar në tabelën nr. 2. Kjo pasuri është krijuar përpara detyrës së subjektit.

### 59.1 Në analizën financiare janë përfshirë:

- i. të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit nga punësimi;
- ii. të ardhurat nga aktiviteti privat si person fizik i shtetasit E.T;
- iii. detyrimet financiare ndaj institucioneve bankare për kreditë e marra në to;

<sup>20</sup> Subjekti ka depozituar: (i) leje qarkullimi datë 20.2.2013; (ii) certifikatë pronësie e regjistrimit automobilistik të Italisë, (iii) akt shitjeje datë 22.6.2009 të mjetit tip “J” N3 A\*\*\* XJ 3.0V\*; (iv) procesverbal nr. \*\*\*, datë 20.11.2011 “Për miratimin e faljes së detyrimit doganor”; (v) faturë doganore për zhbllokimin e mjetit tip “J” datë 20.11.2011, me vlerë 2,190,425 lekë + 361,458 lekë zhdoganim = 2,551,883 lekë.

<sup>21</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2011, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; kthim përgjigjeje e DPSHTRR-së nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2021.

<sup>22</sup> Shihni tabelën nr. 5 të rezultateve të hetimit.



- iv. shpenzimet jetike për 4 persona;
- v. shpenzimet e shkollimit për vajzën G. T;
- vi. shpenzimet TIMS.

**60.** Nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2011, në vlerën - 2,304,869.43 lekë.

**60.1** Në lidhje me këtë rezultat hetimi, duke marrë në konsideratë se kjo pasuri është krijuar përpara fillimit të detyrës së saj, subjektit iu kërkuan shpjegime.

**61.** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi se<sup>23</sup>: “...*bashkëshorti im, me personin që i ka shitur automjetin ka qenë në marrëdhënie shoqërore. Pagesa e këtij mjete, me sa mbaj mend, sepse jam në pamundësi objektive për ta provuar ndryshe, është bërë në disa pjesë dhe në periudha të shtrira kohore. Në vitin 2012, ne kemi marrë edhe një kredi pranë Alpha Bank, në shumën 13,000 euro “Për rikonstruksion banese”, shumë e cila nuk u përdor e gjitha për rikonstruksionin banese, por edhe për likuidimin e makinës”.*

**62.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, vlerëson se nga ana e saj nuk rezulton të jetë provuar me dokumentacion tatimor të ardhurat nga aktiviteti i peshkimit. Gjithashtu, nuk rezulton që subjekti në deklaratën *Vetting* të ketë qartësuar që pagesat për këtë automjet janë bërë në disa pjesë dhe si burim të ketë shërbyer kredia e marrë në Alpha Bank. Për rrjedhojë, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit në vitin 2011. Subjekti në deklaratën *Vetting* është treguar e saktë, duke deklaruar vlerën reale të automjetit dhe jo vlerën e kontratës. Për rrjedhojë, nuk ngrihen dyshime që subjekti është përpjekur të fshehë apo të deklarojë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri. Komisioni, duke marrë në konsideratë konkluzionet në pikën 35 të këtij vendimi, vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme, që kënaqin kërkesat e nenit D/3 të Aneksit Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit ndaj subjektit të rivlerësimit.

**63. Automjet tip “Mercedes-Benz 210”<sup>24</sup>**, prodhim i vitit 2000, me targë AA \*\*\* HI, blerë në datën 9.9.2013 + zhdoganim. Vlera: 185,904 lekë.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** Të ardhurat nga pagat.

### **Hetimi<sup>25</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**64.** Në datën 27.3.2013 (përpara detyrës), i ndjeri/bashkëshorti i subjektit ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz” në çmimin 950 euro. Referuar deklaratës doganore të datës 6.9.2013, rezulton se shpenzimet doganore janë 64,322 lekë. Ky automjet me kontratën nr. \*\*\*, datë 5.5.2019, i është lënë në përdorim vëllait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

<sup>23</sup> Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

<sup>24</sup> Subjekti ka depozituar faturë doganore datë 6.9.2013 për zhdoganimin e mjetit tip “Mercedes-Benz” E\*\*TD me vlerë blerjeje 154,921 + 30,983 lekë zhdoganimi.

<sup>25</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2011, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; kthim përgjigjeje e DPSHTRR-së nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2021; kthim përgjigjeje datë 16.5.2024 e noterit publik V.M.

**65.** Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>26</sup> lidhur me mundësinë e blerjes së pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz 210” sipas dokumentacionit provues, në vlerën 950 euro. Kjo pasuri është krijuar përpara detyrës së subjektit.

**65.1** Në analizën financiare janë përfshirë:

- i. të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit nga punësimi;
- ii. të ardhurat nga aktiviteti privat si person fizik i shtetasit E.T, me NIPT K\*\*\*U;
- iii. detyrimet financiare ndaj institucioneve bankare për kreditë e marra në to;
- iv. shpenzimet jetike për 4 persona;
- v. shpenzimet e shkollimit për vajzat;
- vi. shpenzimet e zhdoganimit për mjetin;
- vii. shpenzimet TIMS.

**65.2** Nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin pasurisë motor uji, në vlerën 950 euro.

**Në përfundim** konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin.

**66. Gjendje cash në vlerën 200,000 lekë**

**Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**67.** Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>27</sup> lidhur me mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* në vlerën 200,000 lekë.

**67.1** Në analizën financiare janë përfshirë:

- i. të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit nga punësimi;
- ii. të ardhurat nga kontratat e qirasë;
- iii. detyrimet financiare ndaj institucioneve bankare për kreditë e marra në to;
- iv. shpenzimet jetike për 5 persona;
- v. shpenzimet e shkollimit për vajzat;
- vi. shpenzimet TIMS

**67.2** Nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vlerën -138,625.67 lekë.

**68.** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi<sup>28</sup>: “*Ju bëj me dije se në datën 30.7.2015 ka lindur vajza jonë e tretë H.T dhe një pjesë e kësaj shume është mbledhur nga dhuratat e familjarëve për lindjen e saj*”.

**69.** Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nuk rezulton që subjekti në deklaratën *Vetting* të ketë deklaruar se ka përfituar dhurata nga familjarët për lindjen e vajzës së saj. Në këto kushte, subjekti është në pamundësi financiare për krijimin e gjendjes *cash*, për rrjedhojë ajo ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*. Duke vlerësuar se kemi të bëjmë me një rezultat negativ me një vlerë relativisht të ulët,

<sup>26</sup> Shihni tabelën nr. 6 të rezultateve të hetimit.

<sup>27</sup> Shihni tabelën nr. 7 të rezultateve të hetimit.

<sup>28</sup> Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

Komisioni çmon se nuk mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit ndaj subjektit të rivlerësimit.

**70. Llogari rrjedhëse pranë Union Bank<sup>29</sup>**, hapur në datën 16.9.2015, ku xhirohet paga mujore dhe qiraja e mjetit të dhënë shoqërisë “A.M” sh.p.k. Gjendja e llogarisë: 266,674.61 lekë.

### **Hetimi<sup>30</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**71.** Nga nxjerrjet e llogarive bankare pranë Union Bank rezulton se në datën 16.9.2015 shtetasi E.T ka hapur llogarinë rrjedhëse nr. \*\*\* në lek. Në këtë llogari rezulton të jenë derdhur qiratë dhe pagat për periudhën 12.10.2015 – 21.1.2017.

Gjendja e llogarisë më 27.1.2017 rezulton të jetë 266,674.61 lekë.

**Në përfundim**, nuk ka paqartësi dhe deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

## **TË ARDHURAT**

### **Deklarimi i bashkëshortit të subjektit në deklaratën *Vetting***

#### **72. Të ardhura nga qiraja**

**72.1** Të ardhura nga dhënia me qira e anijes “B” shoqërisë “A.M” sh.p.k. Në bazë të kontratës së qirasë nr. \*\*\*, datë 21.5.2015, ndryshuar masa e qirasë me kontratën nr. \*\*\*, datë 19.1.2017.

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**72.2** Për të vërtetuar të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj nga dhënia me qira e anijes “B” shoqërisë “A.M” sh.p.k., subjekti me deklaratën *Vetting* ka depozituar:

- i. Kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.5.2015, sipas së cilës qiradhënësi E.T i ka dhënë shoqërisë “A.M” sh.p.k. mjetin anije peshkimi “B”, e tipit *fishing*, viti i prodhimit 1985, për një periudhë 3-vjeçare, që fillon me nënshkrimin e kontratës me të drejtë ripërtëritjeje. Çmimi i qirasë është 50,000 lekë/muaj, shumë e cila do të likuidohet nga qiramarrësi çdo muaj me mandatpagesë të nënshkruar nga të dyja palët.
- ii. Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.11.2015, sipas së cilës kushtet e kontratës së qirasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.5.2015, kanë ndryshuar, duke e zgjatur afatin e qiradhënies nga 3 në 6 vjet.
- iii. Urdhërpagesë 1500, tatim i mbajtur në burim, lëshuar pranë Union Bank, vlera 7,500 lekë. Përshkrimi “Tatim mbi qiranë detyrim principal, duke përfshirë edhe gjobat” deri në datën 18.10.2016, kur është kryer kjo pagesë.
- iv. Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.1.2017, sipas së cilës palët kanë anuluar kontratën e qirasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.5.2015, pasi do të nënshkruajnë një kontratë të re qiraje.
- v. Kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.1.2017, sipas së cilës qiradhënësi E.T i ka dhënë shoqërisë “A.M” sh.p.k. mjetin anije peshkimi “B”, e tipit *fishing*, viti i

<sup>29</sup> Subjekti ka depozituar: (i) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2017, të Union Bank; (ii) nxjerrje llogarie rrjedhëse datë 25.1.2017 të Union Bank.

<sup>30</sup> Kthim përgjigjeje e Union Bank nr. \*\*\*\* prot., datë 23.9.2021.

prodhimit 1985, për një periudhë 3-vjeçare, që fillon me nënshkrimin e kontratës dhe përfundon në datën 18.1.2020. Çmimi i qirasë është 200,000 lekë/muaj, shumë e cila do të likuidohet nga qiramarrësi çdo muaj nëpërmjet bankës.

- vi. Urdhërpagesë nr. 1\*\*\*, datë 24.1.2017, pranë Union Bank, sipas së cilës shoqëria “A.M” sh.p.k. ka kryer transferimin e shumës 170,000 lekë në llogarinë e shtetasit E.T, nën komentin “Qira për anijen B, muaji janar 2017”.
- vii. Urdhërpagesë 1500, tatim i mbajtur në burim, lëshuar pranë Union Bank, vlera 7,500 lekë. Përshkrimi “Tatim mbi qiranë detyrim principal, duke përfshirë edhe gjrobat” deri në datën 18.1.2017, datë kur është kryer kjo pagesë.
- viii. Nxjerrje e llogarisë bankare nr. \*\*\* pranë Union Bank, me titullar bashkëshortin e subjektit, z. E.T, sipas së cilës për periudhën 2015 – 2017 janë kryer pagesa në shumën totale 2,677,500 lekë.

**72.3** Në lidhje me këto të ardhura, DRT Durrës me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së, konfirmon se shuma e detyrimeve tatimore të derdhura nga subjekti “A.M” sh.p.k. lidhur me kontratat e qirasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.5.2015 dhe nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.1.2017, janë paraqitur si në tabelën më poshtë:

**Tabela nr. 2**

Periudha	Qiraja	Tatim qiraje
Maj – dhjetor 2015	400,000.00	60,000.00
Janar – dhjetor 2016	600,000.00	90,000.00
Janar 2017	200,000.00	30,000.00
<b>Total deri në deklaratën Vetting</b>	<b>1,200,000.00</b>	<b>180,000.00</b>

**72.4** Për sa më sipër, këto të ardhura plotësojnë kushtet për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme, duke u përfshirë në analizë financiare.

**73. Të ardhurat nga aktiviteti privat i shoqërisë “B” sh.p.k.,** administrator i shoqërisë dhe aksioner në pjesën prej 100% të kapitalit.

**Hetimi<sup>31</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**74.** QKB-ja informon se i ndjeri, bashkëshorti i subjektit, ka pasur aktivitet ekonomik të regjistruar në emër të tij me NIPT K\*\*\*U, me objekt aktiviteti “Zënie dhe tregtim peshku”, regjistruar në datën 31.7.2009. Në datën 15.6.2021, subjekti është çregjistruar.

**75.** DRT-ja informon se:

- E.T, i datëlindjes 21.4.1977, me ID H\*\*\*D, rezulton se:
  - Ka pasur aktivitet ekonomik të regjistruar në emër të tij me NIPT K\*\*\*U, nën emrin tregtar “P”, me objekt aktiviteti “Zënie dhe tregtim peshku”, regjistruar në datën 31.7.2009.
  - Nga ekstrakti historik i punonjësit rezulton se për periudhën dhjetor 2011 – maj 2015 ka derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si administrator i shoqërisë “P” sh.p.k. Statusi aktual i kësaj shoqërie është “aktiv”.

<sup>31</sup> Kthim përgjigjeje e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2021; kthim përgjigjeje e QKB-së nr. \*\*\* prot., datë 22.9.2021.

- Nga të dhënat e sistemit C@TS rezulton se shtetasi E.T ka deklaruar të ardhura shpenzime, fitim-humbje të subjektit “P” sh.p.k. ndër vite, paraqitur në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 3**

Periudha	Qarkullimi	Fitim/Humbje
2012	1,325,000	1,325,000
2013	1,410,500	-
2014	1,545,800	1,545,800
2015		-
2016		-
2017		-
2018		-
2019		-71,601

Në total, të ardhurat nga aktiviteti i subjektit “B”/“P” deri në deklaratën *Vetting* janë në vlerën 2,870,800 lekë.

### **DETYRIMET FINANCIARE**

**76. Kredi për rikonstrukcion banese** e marrë në datën 1.6.2012 pranë Alpha Bank, dega Durrës, në shumën 13,000 euro, me afat 10 vjet, së bashku me bashkëshortin. Shlyerja fillon në datën 14.6.2012 dhe përfundon më 14.5.2022, me normë interesi 8.55%, me këst mujor 149.64 euro. Teprica e kredisë në datën 20.10.2016 është 8,577.91 euro.

#### **Hetimi<sup>32</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**77.** Subjekti dhe i ndjeri, bashkëshorti i saj, me kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 1.6.2012, kanë marrë kredi në vlerën 13,000 euro, me qëllim ndërtimin e pjesshëm të një pasurie të paluajtshme, që është apartament i ndodhur në Durrës.

**77.1** Nga nxjerrja e llogarisë në Alpha Bank rezulton se huaja është disbursuar në llogarinë nr. \*\*\* në datën 6.6.2012, datë kur i ndjeri, bashkëshort i subjektit, e ka tërhequr *cash* të gjithë shumën 12,990 euro.

**77.2** Detyrimi i paguar deri në datën 20.10.2016 është 8,038.06 euro, nga të cilat principal 4,422.09 euro dhe interes 3,615.97 euro.

Detyrimi i mbetur deri në deklaratën *Vetting* është 8,577.91 euro.

**Në përfundim**, nuk ka paqartësi dhe deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

**78. Kredi konsumatore** e marrë pranë Alpha Bank, dega Durrës, në datën 22.4.2015, në shumën 450,000 lekë, me afat 7 vjet, së bashku me bashkëshortin. Shlyerja fillon në datën 16.4.2015 dhe përfundon më 17.4.2022, me normë interesi 11.8%, me këst mujor 7,728.71 lekë. Teprica e kredisë në datën 20.10.2016 është 383,194.33 lekë.

#### **Hetimi<sup>33</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

<sup>32</sup> Kthim përgjigjeje e Alpha Bank nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2021.

<sup>33</sup> Kthim përgjigjeje e Alpha Bank nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2021.

**79.** Subjekti dhe i ndjeri, bashkëshorti i saj, me kontratë huaje nr. \*\*\*, në datën 22.4.2015 kanë marrë kredi në vlerën 450,000 lekë, me qëllim “Kredi konsumatore”, me kësht mujor 7,278.89 lekë.

**79.1** Kjo kredi është disbursuar në llogarinë nr. AL\*\*\*, llogari dyemërore Orela dhe E.T, në vlerën 450,000 lekë.

**79.2** Detyrimi i paguar deri në datën 20.10.2016 është 129,288.81 lekë, nga të cilat principal janë paguar 66,805.67 lekë dhe interesa 62,478.14 lekë. Detyrimi i mbetur deri në deklaratën *Vetting* është 383,194.33 lekë.

**80. Kartë krediti Visa** me limit 50,000 lekë. Shuma e mbetur 50,000 lekë.

#### **Hetimi<sup>34</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**80.1** Nga nxjerrjet e llogarive bankare pranë Alpha Bank, dega Durrës, rezulton se znj. Orela Troplini është mbajtëse e kartës së kreditit Visa, me limit 50,000 lekë. Kjo kartë është rimbursuar nga llogaria e pagës së subjektit nga data 16.12.2015 e në vazhdim.

**Në përfundim,** nuk ka paqartësi dhe deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

**81. Kredi për qëllime personale,** marrë në datën 23.1.2007 pranë Raiffeisen Bank, dega Durrës, në shumën 500,000 lekë, me afat 60 muaj, së bashku me bashkëshortin. Shlyerja ka përfunduar në datën 8.2.2012. Në vitin 2004, në Raiffeisen Bank, llogaria e kursimit në vazhdim figuron e mbyllur, me gjendje 0 (zero).

#### **Hetimi<sup>35</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**82.** Nga nxjerrjet e llogarive bankare pranë Raiffeisen Bank, rezulton se:

- Subjekti dhe i ndjeri, bashkëshorti i saj, me kontratë huaje janë bashkë kredimarrës për kredinë në vlerën 500,000 lekë, me qëllim “Kredi konsumatore”.

- Kjo kredi është disbursuar në llogarinë nr. AL\*\*\*, në emër të znj. Orela Troplini, në datën 24.1.2007. Komisionet e disbursimit 10,635.63 lekë. Shlyerja ka përfunduar në datën 8.2.2012.

**Në përfundim** nuk ka paqartësi dhe deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

### **GJETJE TË TJERA QË LIDHEN ME PASURI PAS DEKLARATËS VETTING**

**83.** Komisioni, me qëllim krijimin e bindjes së brendshme në lidhje me subjektin e rivlerësimit, ka kryer një hetim të plotë të pasurive të saj të krijuara pas deklaratës *Vetting*, pavarësisht faktit që ato nuk janë objekt hetimi të këtij Komisioni. Nga ky hetim ka rezultuar se për këto pasuri subjekti ka pasur burime të ligjshme dhe nuk ngrihen dyshime që nga ana e saj janë fshehur pasuri apo janë krijuar të ardhura jo të ligjshme. Pas marrjes së detyrës, subjekti nuk rezulton me mungesë burimesh të ligjshme, duke treguar kujdesin e duhur në krijimin e pasurive të saj.

#### **Deklarimi i subjektit në pyetësin standard**

<sup>34</sup> Kthim përgjigjeje e Alpha Bank nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2021.

<sup>35</sup> Kthim përgjigjeje e Raiffeisen Bank nr. \*\* prot., datë 13.9.2021.

**84. Blerje garazhi**, ndodhur në Lagjen Nr. 12, me nr. pasurie \*\*\*-Nd+\*-G\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\* fq. \*\*\*, me sip. 25 m<sup>2</sup>, blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.7.2017, me çmimin 10,000 euro. Burimi i krijimit: Blerë me të ardhurat e krijuara nga dëmshpërblimi i anijes “B”, por edhe kursime të tjera familjare të krijuara përgjatë vitit 2017.

### **Hetimi<sup>36</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**85.** I ndjeri, bashkëshorti i subjektit, me kontratë nr. \*\*\*, datë 4.7.2017, ka blerë garazh në qytetin e Durrësit, me sipërfaqe 25 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*-Nd-G\*, z. k. \*\*\*, për shumën 10,000 euro. Kjo pasuri ndodhet në të njëjtën godinë ku ndodhet edhe apartamenti i subjektit. Pagesa e shumës 10,000 euro provohet me depozitë në arkë datë 4.7.2017, në Alpha Bank, ku i ndjeri, bashkëshort i subjektit, ka depozituar këtë shumën në llogarinë e noterit publik.

**85.1** Subjekti në pyetësin standard ka deklaruar *“Të ardhura në shumën 61,000 euro nga siguracioni N of E.P And I. A Ltd N, për shkak të dëmtimit aksidentalisht të anijes “B” në pronësi të bashkëshortit E.T”*.

**85.2** Për të vërtetuar këtë fakt, subjekti ka depozituar *statement*-in bankar të bashkëshortit, të llogarisë së tij nr. \*\*\* pranë Union Bank, në të cilin në datën 3.3.2017 është kredituar shuma 61,000 euro, nën komentin *“I M-likuidim në llogari \*\*\*, \*\*\* N of E.P and I.A Ltd N upon T, N\* \*\*\*”*.

**85.3** Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar: *“Megjithatë di që pas marrjes së dëmshpërblimit nga kompania e sigurimit (për dëmtimet e kryera në anijen “B” nga një traget i shoqërisë \*\*\*) ai shpenzoi rreth 40,000 euro për riparimin total të anijes “B”...”*.

**86.** Komisioni konstaton se i ndjeri, bashkëshort i subjektit, ka përfituar një shumë prej 61,000 euro, ndërkohë që ai ka shpenzuar vetëm 40,000 euro për riparimin e anijes dhe 30,000 USD për blerjen e saj.

**86.1** Për rrjedhojë, duket se vlera e dëmshpërblimit nuk përputhet me vlerën e shpenzimeve të kryera, duke i kaluar subjektit barrën e provës.

**87.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se: *“Anija “B”, sipas shpjegimeve të vjehrrit tim, ka qenë një anije ruse, e cila u ankorua pranë portit malazez për t’u pajisur me licencë pranë këtij shteti, por duke qenë se anija nuk i plotësonte kushtet për t’u licencuar në shtetin malazez, sepse ishte e tonazhit të lartë dhe gjatësia e saj ishte më e madhe sa parashikonte ligji i asaj kohe, ka mbetur e bllokuar në qytetin Bar të Mal të Zi, së bashku me ekuipazhin, për një periudhë të gjatë kohore. Duke qenë se kjo anije mbeti e bllokuar aty dhe pronarët e saj rusë hoqën dorë nga veprimet e mëtejshme për licencimin e saj, vendosën ta shisnin atë në vlerën e taksave portuale, pasi nuk mund ta kthenin pas në shtetin e tyre. Pra, çmimi i blerjes 30,000 euro nuk ka qenë vlera reale e kësaj anijeje, por ka qenë vlera e taksave dhe detyrime që ky mjet ka pasur në Portin e Barit në Malin e Zi.*

*Fakti është se kontrata e kësaj anijeje është bërë në zyrat e Gjykatës Themelore në Bar O. V., çka tregon se të gjitha veprimet kanë qenë të ligjshme dhe ka qenë shteti malazez që ka ndërhyrë për shitjen e kësaj anijeje, duke qenë se edhe ai do ishte përfituesi i shumës për shkak se ishin taksat portuale. Për të sjellë një anije nga një shtet i huaj ka një sërë procedurash, të cilat kryhen nga organet shtetërore përkatëse, që janë kapiteneritë e porteve përkatëse dhe*

<sup>36</sup> Kthim përgjigjeje datë 16.5.2024 e noterit publik A.H.

zyrat e regjistrimit detar, e më pas edhe Ministria e Transportit, e cila i licencon... Në lidhje me siguracionin N of E.P and I.A Ltd N, në shumën 61,000 euro, ju sqarohet se në Portin e Durrësit, për shkak të kushteve atmosferike ndodhi një aksident detar, ku tragjetit që transportonte materialet e shoqërisë “\*\*\*” (Gazsjellësi T.A) iu këputën litarët dhe goditi disa anije peshkimi, një ndër to edhe anijen e bashkëshortit tim. Në lidhje me dëmet e shkaktuara, u kryen disa ekspertime nga institucionet shqiptare dhe kompania e sigurimit, e cila ishte e huaj, jo shqiptare, ishin ata që nxorën edhe vlerën e dëmeve të shkaktuara. Në lidhje me vlerën e riparimeve të kryera për këtë anije, ju sqarohet se në qytetin e Durrësit nuk kishte një kantier për riparimin e anijeve të tonazhit të rëndë, sikurse ishte anija “B”, pasi ishte anije hekuri, jo druri, gjithashtu edhe dërgimi i saj në Itali ishte i pamundur, për shkak të dëmtimeve që kishte marrë nga goditja. Pas kërkesës sonë me shkrim, shërbimi për riparimin e anijes na u ofrua nga Baza Ushtarake e Pashalimanit, Vlorë, e cila normalisht, meqenëse ishte një institucion shtetëror, na tarifoi me çmime shtetërore për nxjerrjen e anijes dhe qëndrimin e saj në dok, për aq sa ditë ka qëndruar anija deri në përfundimin e punimeve. Më tej, të gjitha punimet janë bërë nga ekuipazhi i anijes dhe bashkëshorti e vjehri im. Ky më sipër është shkaku përse vlera e dëmshpërblimit nuk përputhet me shpenzimet e kryera, sepse punimet për nxjerrjen dhe riparimin e anijes janë kryer në një kantier shtetëror dhe jo në një kantier privat”.

**88.** Pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerëson se ato janë bindëse. Gjithashtu, në lidhje me këtë kompensim, nuk ngrihen dyshime për vlerë fiktive, pasi transaksioni është bërë nëpërmjet sistemit bankar nga një kompani e huaj me qendër në Britaninë e Madhe.

**89.** Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>37</sup> lidhur me mundësinë për blerjen e pasurisë garazh në Durrës, blerë në datën 4.7.2017 sipas dokumentacionit provues, në vlerën 10,000 euro.

**89.1** Nga nxjerrjet e llogarisë bankare nr. \*\*\* të shtetasit E.T pranë Union Bank, rezulton se në datën 4.7.2017 ky shtetas ka tërhequr *cash* shumën 10,000 euro.

**89.2** Nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin pasurisë garazh, në vlerën 10,000 euro.

**90. Blerje motor deti “Kawasaki Aria”,** me nr. regj. \*\*\*, vit prodhimi 2007, blerë nga bashkëshorti me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 14.5.2018, në vlerën 5,000 euro. Shitësi i këtij mjeti është shtetasi E.T.

**90.1** Subjekti sqaron se me deklaratën noteriale të huas nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.4.2017, provohet se bashkëshorti i ka dhënë hua vëllait E.T në masën 10,000 euro. Shuma e blerjes së këtij mjeti është konsideruar si shlyerje e një pjese të huas së marrë nga shtetasi E.T. Burimi i huas së dhënë vëllait janë kryesisht të ardhura të përfituar nga dëmshpërblimi i anijes “B”, kursimet, si dhe të ardhurat e tjera familjare, përfshirë edhe pakësime të gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

### **Hetimi/<sup>38</sup>analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**91.** Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se i ndjeri, bashkëshort i subjektit, ka blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 14.5.2018, një mjet të vogël lundrues, motor deti, në shumën 5,000 euro,

<sup>37</sup> Shihni tabelën nr. 8 të rezultateve të hetimit.

<sup>38</sup> Kthim përgjigjeje datë 16.5.2024 e noterit publik V.M.



nga vëllai i tij E.T. Në kontratë përcaktohet se palët janë marrë vesh që pagesa prej 5,000 euro të njihet si shlyerje e një pjese të huas bazuar në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 12.4.2017.

**91.1** Bashkëlidhur kontratës gjendet edhe deklarata noteriale nr. \*\*\*, sipas së cilës bashkëshorti i subjektit i ka dhënë hua vëllait të tij shumën 10,000 euro, me afat 1-vjeçar.

**92.** Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>39</sup> lidhur me mundësinë për dhënien e huas sipas dokumentacionit provues, në vlerë 10,000 euro.

**92.1** Në analizën financiare janë përfshirë:

- i. të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit nga punësimi;
- ii. të ardhurat nga kontrata e qirasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.1.2017;
- iii. të ardhurat nga shitja e automjetit me targë AA \*\*\* AR, datë 12.9.2017;
- iv. dhënie huaje ndaj vëllait E. T;
- v. të ardhurat nga dëmshpërblimi *N of E.P and I*;
- vi. detyrimet financiare ndaj institucioneve bankare për kreditë e marra në to;
- vii. shpenzimet jetike për 5 persona;
- viii. shpenzimet e shkollimit për vajzat;
- ix. shpenzimet për rregullimin e anijes pas dëmshpërblimit;
- x. shpenzimet TIMS.

**92.2** Nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas ndaj vëllait E. T, në vlerën 10,000 euro.

**93.** Subjekti ka deklaruar se: *“Gjatë pushimeve verore qëndrojmë në shtëpinë në Himarë (Vlorë), të blerë sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 12.2.2018 “Blerje apartamenti me sip. 54.7 m<sup>2</sup>, me nr. regjistri hipotekor. Blerë me kredi 7,500,000 lekë pranë Alpha Bank”.*

#### **Hetimi<sup>40</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**94.** Në datën 12.2.2018, me kontratë shitjeje me rezervë nr. \*\*\*, subjekti dhe i ndjeri, bashkëshorti i saj, kanë blerë në Himarë apartamentin me sipërfaqe totale 54.7 m<sup>2</sup> dhe ballkon me sipërfaqe 8.8 m<sup>2</sup>, për shumën 7,500,000 lekë. Në nenin C, kushtet e kontratës, përcaktohet se çmimi i shitjes do të likuidohet totalisht me kredinë që do t’i akordohet palës blerëse prej Union Bank.

**94.1** Bazuar në vërtetimin hipotekor rezulton se në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 20.2.2018, rezulton se subjekti dhe i ndjeri, bashkëshorti i saj, janë pronarë të pasurisë me sip. 54.7 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*

**94.2** Kjo pasuri me kontratë hipoteke nr. \*\*\*, datë 23.2.2018, është vënë në hipotekë për të garantuar kredinë e marrë në Union Bank.

**95.** Në datën 23.2.2018, subjekti dhe bashkëshorti i saj i ndjerë kanë lidhur me Union Bank kontratë kredie bankare hipotekore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., me objekt “Blerje shtëpie”. Shuma e kredisë 7,500,000 lekë, për një periudhë 84 mujore (7 vjet). Për të garantuar përmbushjen e kushteve të kredisë subjekti dhe bashkëshorti i saj me kontratë hipoteke nr. \*\*\*, datë 23.2.2018, kanë vendosur si garanci në formën e hipotekës pasurinë apartament, me sipërfaqe totale 96

<sup>39</sup> Shihni tabelën nr. 9 të rezultateve të hetimit.

<sup>40</sup> Kthim përgjigjeje datë 20.5.2024 e noterit publik R.J; kthim përgjigjeje datë 22.5.2024 e noterit publik J.V; kthim përgjigjeje e Union Bank nr. \*\*\* prot., datë 23.9.2021.

m<sup>2</sup>, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. pasurie \*\*\*-Nd+\*-\*\*, vol. \*\*, fq. \*\*\*, z. k.\*\*\*, ndodhur në Durrës, në pronësi të shtetasve E.T dhe Orela Troplini.

**95.1** Në kontratën e kredisë përcaktohet se menjëherë pas disbursimit shuma do të lejohet të transferohet në llogarinë e noteres J.V me qëllim kalimin e këtyre fondeve në llogarinë e shitësit sipas kontratës së shitjes me rezervë nr. \*\*\*, datë 12.2.2018.

**96.** Nga nxjerrja e llogarisë bankare pranë Union Bank rezulton se në datën 26.3.2018 është disbursuar shuma 7,500,000 leke në llogarinë e pagës së bashkëshortit të subjektit. Kjo shumë është transferuar në llogari të noteres J.V me qëllim kalimin e këtyre fondeve në llogarinë e shitësit sipas kontratës së shitjes me rezervë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.2.2018.

**97.** Në lidhje me shlyerjen e kësaj kredie, konstatohet se ajo është shlyer në mënyrë periodike nga muaji prill 2018 deri në dhjetor 2019 sipas plan-pagesave të përcaktuara në kontratën e kredisë. Në datën 6.1.2020, kompania S sh.a. ka depozituar në llogarinë e të ndjerit E.T shumën 6,125,115.62 lekë, të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e plotë të kredisë.

**98.** Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie, si dhe për shlyerjen e kredisë së marrë.

#### **99. Apartament i blerë në datën 1.6.2020**

##### **Hetimit<sup>41</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**100.** Në datën 1.6.2020, me kontratën nr. \*\*\*, datë 1.6.2020, subjekti ka blerë një apartament me sipërfaqe 97.1 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe e përbashkët 11.98 m<sup>2</sup>, për shumën 50,000 euro. Si burim për këtë apartament subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e anijes “B”.

**100.1** Në lidhje me këtë anije, rezulton se në datën 27.4.2020 me kontratë shitjeje nr. \*\*\* subjekti<sup>42</sup> e ka shitur për shumën 148,000 euro. Në datën 27.4.2020, me deklaratën noteriale nr. \*\*\* subjekti deklaroi se blerësi J.T ka depozituar shumën 148,000 euro në llogarinë e saj në Intesa Sanpaolo Bank.

**101.** Nga nxjerrjet e llogarive bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank rezulton se:

- Në datën 27.4.2020, në llogarinë nr. \*\*\* në euro të subjektit, nën komentin “J.K.T – Rr. “Dh.S”, kalim sipas kontratës shitje pasuri të paluajtshme anije barkë peshkimi, mjet lundrimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.4.2020” është kredituar shuma 148,000 euro.
- Në datën 5.5.2020, subjekti tërheq *cash* nën komentin “Tërheq për t’i depozituar në një bankë tjetër” shumën 5,000 euro.
- Në datën 13.5.2020, subjekti tërheq *cash* nën komentin “Tërheq për t’i depozituar në FiBank” shumën 50,000 euro.
- Në datën 15.5.2020, subjekti tërheq *cash* nën komentin “Tërheq për t’i depozituar në FiBank” shumën 50,000 euro.
- Në datën 2.6.2020, subjekti tërheq *cash* nën komentin “Tërheq për t’i depozituar në ABI Bank për blerje apartamenti” shumën 15,000 euro.

<sup>41</sup> Kthim përgjigjeje datë 16.5.2024 e noterit publik J.B; kthim përgjigjeje datë 30.5.2024 e noterit publik M.N; kthim përgjigjeje e ABI Bank nr. \*\*\* prot., datë 10.9.2021; kthim përgjigjeje e FiBank nr. ON-A-\*\*\*, datë 13.9.2021; kthim përgjigjeje e Intesa Sanpaolo Bank nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2021.

<sup>42</sup> Në cilësinë edhe të përfaqësueses së fëmijëve të saj me vendim gjykatë nr. \*\*\*, datë 14.2.2020.

- Në datën 3.6.2020, subjekti tërheq *cash* nën komentin “Tërheq për t’i depozituar në ABI Bank për blerje apartamenti” shumën 15,000 euro.

**102.** Nga nxjerrjet e llogarive bankare pranë FiBank rezulton se:

- Në datën 3.3.2020, subjekti i rivlerësimit, znj. Orela Troplini, ka hapur llogarinë rrjedhëse nr. AL\*\*\*\*Eur\*\*\* pranë kësaj banke.
- Në datën 13.5.2020 depoziton në llogari nën komentin “Derdhje në llogari *paid in cash*” shumën 50,000 euro.
- Në datën 15.5.2020 depoziton në llogari nën komentin “Derdhje në llogari *paid in cash*” shumën 50,000 euro.
- Në datën 3.6.2020, subjekti tërheq nga llogaria nën komentin “*Drawn in cash*” shumën 20,000 euro, të cilën e depoziton në llogarinë e saj pranë ABI Bank nr. \*\*\*, në datën 3.6.2020.
- Në datën 18.6.2020, gjendja e llogarisë është 80,000 euro. Në këtë datë subjekti Orela Troplini ka blerë nga bondi që ka emetuar FiBank vlerë nominale bondi 80,000 euro, emetuar në datën 18.6.2020, me datë maturimi 18.6.2027.

**103.** Nga nxjerrjet e llogarive bankare pranë ABI Bank rezulton se:

- Në datën 3.6.2020, subjekti depoziton në llogarinë e saj nr. \*\*\* shumën 35,000 euro, nën komentin “Orela Troplini depozitim në llogari të ardhura nga tërheqja në FiBank (ish-Intesa) blerje apartamenti me kontratë premtimi nr. \*\*\*, datë 1.6.2020”.
- Në datën 3.6.2020, subjekti depoziton në llogarinë e saj nr. \*\*\* nën komentin “Depozitim *cash* të ardhura të tërhequra nga Intesa Sanpaolo Bank” shumën 15,000 euro.
- Në datën 3.6.2020, subjekti Orela Troplini, nën komentin “Kalim nga Orela Troplini sipas kontratës premtimi shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.6.2020, në favor të R.M (me prokurë shitësit I.K)”, transferon shumën 50,000 euro.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

**104.** Nga aktet noteriale rezulton se:

- Subjekti, në datën 4.9.2020, me deklaratë noteriale nr. \*\*\* i ka dhënë hua shumën 8,000 shtetasit E.T, ku si burim janë deklaruar kursimet e subjektit në Intesa Sanpaolo Bank dhe Alpha Bank.

Si burim për këtë hua kanë shërbyer gjendjet në llogaritë bankare të subjektit, si vijon:

- Nga nxjerrja e llogarisë bankare nr. AL\*\*\*\* pranë Alpha Bank rezulton se gjendja e kësaj llogarie në datën 1.9.2020 të jetë 5,000 euro. Në këtë datë subjekti Orela Troplini ka tërhequr 4,997 euro nën komentin “Tërheqje nga Orela Troplini”.
- Nga nxjerrja e llogarisë bankare nr. \*\*\* pranë Intesa Sanpaolo Bank rezulton se gjendja e kësaj llogarie në datën 10.6.2020 të jetë 12,992.45 euro.
  - Në datën 10.6.2020, subjekti ka tërhequr shumën 2,000 euro nën komentin “Tërheqje për shpenzime”.

- Në datën 1.9.2020, subjekti ka tërhequr shumën 3,000 euro nën komentin “Tërheqje për shpenzime”.

ii. Në datën 7.11.2019 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore për të ndjerin E.T, duke u përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë subjekti i rivlerësimit dhe tre fëmijët e saj, duke përfituar ¼ pjesë takuese të pasurive dhe detyrime të të ndjerit.

**105.** Në përfundim të analizës financiare prej fillimit të detyrës deri në deklaratën *Vetting*, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurive të tyre në vlerën -138,625.67 lekë, e cila nuk është e mjaftueshme për të vlerësuar se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

### **Konkluzion për vlerësimin e pasurisë**

**106.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**107.** Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ajo ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Orela Troplini, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

**108.** Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaram dhe balanca negative e fondeve në vlerën -138,625.67 lekë, nuk është e mjaftueshme që të pasjellë aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

**109.** Komisioni vlerëson të ndalet edhe në disa fakte të cilat lidhen me pasuritë e krijuara shumë kohë para fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, për të cilat subjektit i janë kërkuar shpjegime.

**109.1** Në lidhje me burimin e këtyre pasurive, nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se i ndjeri, bashkëshorti i subjektit, dhe babai i tij kanë kryer aktivitet tregtar me xhiro dhe fitim të konsiderueshëm. Këto të ardhura, pavarësisht se nuk kënaqin përcaktimin e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës, duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, pasi provohet që i ndjeri dhe babai i tij mund të kenë pasur të ardhura për të krijuar këto pasuri. Komisioni mban në konsideratë faktin se, megjithëse provat e disponueshme nga institucionet shtetërore nuk konfirmojnë legjitimitetin e të ardhurave të pretenduara prej subjektit, duke qenë se në organet tatimore kompetente nuk disponohen të dhëna që konfirmojnë pagimin e tatimit, duke qenë se provat sugjerojnë se personat e lidhur të subjektit kanë pasur një aktivitet aktiv dhe gjasat janë që ata e kanë kryer aktivitetin në përputhje me kuadrin ligjor të kohës dhe në mungesë të ndonjë treguesi, që të bënë të dyshosh se subjekti i rivlerësimit, me deklaramin e të ardhurave të tilla, ka synuar të mashtronte organet e rivlerësimit ose ka deklaruar qëllimisht ndryshe në mënyrë të rreme, vlerëson se kjo situatë faktike nuk çmohet se është e drejtë të konsiderohet si një mangësi apo defekt i cili të prodhojë për subjektin

e rivlerësimit si pasojë vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra. Kjo mangësi mbetet e vetmja e konstatuar lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe, e vendosur në kontekstin e mësipërm, nuk vlerësohet se ajo mund të prodhojë në mënyrë proporcionale vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra, si një masë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Komisioni çmon se periudha në të cilën i ndjeri, bashkëshorti i subjektit, dhe prindërit e tij kanë investuar për krijimin e këtyre pasurive ka qenë përtej kohës kur subjekti kishte detyrën e ndihmësit ligjor.

**109.2** Trupi gjykues konstaton se pavarësisht problematikave që mund të rezultojnë si pasojë e analizës financiare për provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave, që kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive, nga hetimi administrativ i Komisionit nuk u ngritën dyshime lidhur me krijimin e këtyre të ardhurave nga aktivitete të kundërligjshme të personit të lidhur. Si rrjedhojë, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet e dijenisë dhe të pranimit të faktit që ka pranuar të përdorë të ardhura, për të cilat ka ditur se janë krijuar nga burime të kundërligjshme, situatë kjo që do ta bënte të cenueshëm besimin e publikut për subjektin e rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues, në vlerësim të situatës faktike, si dhe në përputhje edhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>43</sup>, çmon se problematikat e konstatuara nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe se ato nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në procesin e rivlerësimit kalimtar për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit.

**110.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Orela Troplini, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**111.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Orela Troplini, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

**112.** Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar në Komision raportin<sup>44</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Orela Troplini, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

<sup>43</sup> Shihni vendimin nr. 6/2022.

<sup>44</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\*, datë 14.10.2022.

**113.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

**114.** Komisioni kreu një hetim<sup>45</sup> të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, znj. Orela Troplini Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, edhe pas përditësimit të informacionit, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

### **Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**115.** Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Orela Troplini, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**116.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor**

**117.** Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**118.** Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

**119.** Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

**120.** Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti dhe analizimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short nuk u konstatuan problematika.

**121.** Subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në testimin e kryer nga Shkolla e Magjistraturës në datat 7-8 maj 2018. Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.5.2018, të Shkollës së

---

<sup>45</sup> Shihni dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

Magjistraturës, konstatohet se subjekti, në fazën e parë, ka arritur të marrë 42 pikë nga 100 në total, ndërsa në fazën e dytë ka arritur të marrë 125 pikë nga 200 në total.

### **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-së**

**122.** Nga analiza e të dhënave të rezultuara nga përmbajtja e formularit të vetëvlerësimit, por edhe akteve të tjera, pjesë e dosjes së vlerësimit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Orela Troplini, deri më sot, nuk ka ushtruar asnjëherë funksionin e gjyqtarit pranë ndonjë gjykate të shkallës së parë apo Apeli, prandaj, për këtë subjekt, nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLGJ-së për periudhën e rivlerësimit.

**122.1** Si rezultat, të dhënat profesionale dhe etike për këtë subjekt janë marrë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, ku znj. Orela Troplini ka ushtruar detyrën si ndihmëse ligjore.

### **DENONCIME**

**123.** Nga verifikimi i kryer nuk rezultojnë denoncime të regjistruara për subjektin e rivlerësimit.

### **Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

**124.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën subjektit.

**125.** Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

**126.** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Orela Troplini, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 22.10.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Roland ILIA**  
**Kryesues**

**Genta Tafa (BUNGO)**  
**Relatore**

**Xhensila PINE**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Suana Stafa*